



8.05.2017



55/4
08. 05. 2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATE/A:	05.05.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 55/4
PËR/ZA/TO:	Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturore nr.24/2017 të dt. 26.04.2017 për lëndën Sejid Shatri Nr.04-353-070/50-14280 për renovimin e brendshëm, ndërrimin e vitrinës dhe ndërrimin e kulmit të lokalit në ngastrën kadastrale Nr. 3399-0

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.



209 04.08.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 24/2017
Datë: 26.04.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi, 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: “Miratimi me vërejtje, i kërkesës/ projektit për renovimin të brendshëm, ndërrimin e vitrines dhe të kulmit të lokalit, në ngastrën kadastrale Nr. 3399 – 0 Z. K. Prizren, me pronar Sejid Shatri”.
2. Në bazë të rekomandimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues, i cili duhet të dorëzohet dhe miratohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas Projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e një eksperti nga Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Sejid Shatri nga Prizreni ka parashtruar kërkesën për renovimin e brendshëm, ndërrimin e vitrinës dhe ndërrimin e kulmit të lokalit, në ngastrën kadastrale me Nr. 3399 – 0. Objekti që do të rinovohet, gjendet në Zonën e I – rë (zona e tregut tradicional) sipas Planit të Konservimit – në Sheshin e Shadërvanit. Në afërsi të lokalit është Kroi i Shadërvanit si dhe Ura e Gurit dhe Xhamisë së Sinan Pashës që janë në listën e MKRS – së. “Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme” (10.10.2016 – 10.10.2017). Objekti është në rrugën “Kurrilla” me Nr. 52. Pas shqyrtimit të intervenimeve të paraqitura nga pala, Komisioni i rekomandon ato për implementim, sepse të njëjtat janë në harmoni me intervenimet mirëmbajtëse për monumente. Komisioni vërejtë dhe diskutoi për mos përputhshmeri mes prerjës dhe dukjes së paraqitur, dhe vlerëson se kulmi duhet të ekzekutohet sikurse në prerje.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka rekomanduar si në vijim:

1. Aprovohet me vërejtje kërkesa për renovimin e brendshëm, ndërrimin e vitrinës dhe të kulmit të lokalit, në ngastrën kadastrale me Nr. 3399 – 0. Intervenimet janë në harmoni me praktikën e mira evropiane për mirëmbajtjen e monumenteve.
2. Njoftohet pala se Projektin Kryesor, të Projektit Ideor të miratuar nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, duhet ta dorëzojë në QRTK – Prizren për verifikim (të gjitha kopjet e projektit që i nevojiten palës). Dy kopje dixhitale dhe dy kopje fizike të projektit kryesor mbeten në QRTK - Prizren (një për QRTK – në dhe një për IKMM – në).

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrisë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM – së;
- Arkivit të IKMM – së;
- Arkivit të MKRS – së;

Agim Gërguri
U.D. Drejtor

